



## **Republika e Kosovës**

### **Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Qeveria -Vlada-Government*

*Ministria e Arsimit dhe Shkencës*

*Ministarstvo Obrazovanja i Nauke / Ministry of Education and Science*

## **Thirrje publike për nominim të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës**

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 04/L-135 për veprimtari kërkimore-shkencore, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, e Republikës të Kosovës, shpall thirrje publike për nominimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës.

### **1. Këshilli Kombëtar i Shkencës**

(Nenet 40, 42 dhe 43 i Ligjit)

1.1. Këshilli Kombëtar i Shkencës, është trup profesional i themeluar nga Kuvendi i Kosovës që përkujdeset për zhvillimin sistemor të veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe teknologjike në Republikën e Kosovës. Këshilli Kombëtar i Shkencës përbëhet prej pesëmbëdhjetë (15) anëtarëve.

1.2. Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Shkencës, i emëron Kuvendi, me propozim të Qeverisë, me mandat prej katër (4) vjetësh.

1.3. Në Këshillin Kombëtar të Shkencës, duhet të sigurohet përfaqësimi adekuat i institucioneve kërkimore - shkencore, i fushave prioritare të shkencës dhe i autoriteteve shkencore.

### **2. Detyrat e Këshillit Kombëtar të Shkencës**

(Neni 41 i Ligjit)

Këshilli Kombëtar i Shkencës:

- I paraqet Qeverisë së Kosovës propozimin e Programit Kombëtar të Shkencës;
- Vlerëson, në aspektin krahasimtar, gjendjen në veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe teknologjike, pozitën dhe zhvillimin e saj në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Jep mendimin për nevojën e themelimit, ristrukturimit apo suprimimit të instituteve kërkimore-shkencore;

- Propozon dhe nxit ndërmarrjen e masave për përparimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore;
- Shqyrton çështje të rëndësishë së veçantë që kanë të bëjnë me sistemin kombëtar të inovacioneve si dhe propozon dhe nxit ndërmarrjen e masave për përparimin e tij në funksion të zhvillimit teknologjik;
- Shqyrton dhe jep mendimin për çështje të tjera të rëndësishme për zhvillimin e gjithëmbarshtëm të vendit, sipas kërkesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

### **3. Nominimi i anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës**

(Neni 7 dhe 43 i Ligjit)

3.1. Të drejtën e nominimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës e kanë institucionet shkencore të Kosovës që përcaktohen me nenin 7 të Ligjit:

- Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës;
- Universitetet;
- Instituti Albanologjik;
- Instituti i Historisë dhe
- Institucionet tjera kërkimore -shkencore dhe të arsimit të lartë.

3.2. Institucionet shkencore të Kosovës, i propozojnë Ministrisë përkatëse për shkencë anëtarët e Këshillit Kombëtar të Shkencës;

3.3. Në Këshillin Kombëtar të Shkencës duhet të sigurohet përfaqësimi adekuat i institucioneve kërkimore- shkencore, i fushave prioritare të shkencës dhe i autoriteteve shkencore.

3.4. Institucionet të cilat japin propozimet për anëtarët e Këshillit Kombëtar të Shkencës, duhet të prezantojnë veprimtarinë e përgjithshme shkencore dhe profesionale për secilin kandidat të propozuar;

3.5. Ministria përkatëse për shkencë mund t'i propozojë Qeverisë së Republikës së Kosovës edhe ndonjë kandidat tjetër që nuk është propozuar nga institucionet shkencore të Kosovës, në pajtim me paragrafin 1 dhe 3 të nenit 43 të Ligjit.

### **4. Dokumentacioni i nominimit**

Dokumentacioni i nominimit përmban:

4.1. Formularin e nominimit të plotësuar dhe nënshkruar nga personi i nominuar dhe personi i autorizuar i institucionit shkencor që ka bërë nominimin (p.sh. kryetari i ASHAK, drejtori i institutit, rektori i Universitetit, etj.). Formulari mund të shkarkohet nga uebfaqja <https://mash.rks-gov.net/alldocuments/formulari-per-nominim-kksh-2026/>

4.2. Prezentimin e veprimtarisë shkencore dhe profesionale të të nominuarit e cila mund të ketë formën e një raporti narrativ për të nominuarin ose mund të prezantohet CV-ja e të nominuarit në formë tabelare (në njërën nga gjuhët zyrtare të Kosovës ose në gjuhën angleze). Është me rëndësi

që prezantimi i veprimtarisë të përmbajë në vete listën e publikimeve ose arritjeve shkencore të të nominuarit.

**Vërejtje:** Në këtë fazë nuk është e nevojshme të bashkëngjiten dokumente të tjera, si diploma, certifikata, publikime, e të tjera.

## **5. Dorëzimi i nominimeve dhe afatet**

5.1. Nominimet dorëzohen në formë elektronike, ku për secilin kandidat të nominuar përgatitet **një dokument i vetëm** në formatin PDF që përmban formularin e nominimit të skanuar (pika 4.1) dhe prezentimin e veprimtarisë shkencore dhe profesionale të të nominuarit (pika 4.2).

5.2. Dokumentet e nominimit dërgohen me e-mail në adresat: [sebahate.jupolli@rks-gov.net](mailto:sebahate.jupolli@rks-gov.net) dhe [fidan.kozhani@rks-gov.net](mailto:fidan.kozhani@rks-gov.net). Nominimet nga një institucion mund të dërgohen si dokumente të bashkëngjitura në një e-mail ose në e-mail të veçantë. Pranimi do të konfirmohet përmes e-mailit nga MASH, jo më vonë se në ditën vijuese të punës.

5.3. Afati i fundit për dërgimin e nominimeve është **data 5.V.2026, në orën 16:00**.

**Vërejtje:** Nominimet që nuk janë konform formatit të përcaktuar në pikën 5.1, dorëzohen në ndonjë formë tjetër nga ajo e përcaktuar në pikën 5.2, dërgohen nga subjekte që nuk e kanë të drejtën e nominimit siç është përcaktuar në pikën 3.1, dërgohen nga e-mail adresa jozyrtare (si gmail, hotmail, e të ngjashme) ose dërgohen pas afatit të përcaktuar në pikën 5.3; **nuk do të shqyrtohen**.